



Historia e lavdishme e arsimimit që nisi në vitin 1920 kur 10 vajza hynë në ndërtesën shtetërore në Bishanakë, jo vetëm duke thyer mentalitetin shtypës për femrat, por edhe duke u bërë qendra më e fuqishme edukative e qytetit. Figurat e shquara që dolën nga bangat e institucionit

Historia e arsimit në qytetin e Fierit, ashtu si për gjithë qytetet e tjerë të vendit, është e lidhur ngushtë me përpjekjet e vazhdueshme patriotike për arsimimin e femrës shqiptare. Para hapjes së shkollës shqipe, në Fier ka pasur një shkollë greke pesë klasëshe për djem. Por krahas saj Fieri ka pasur gjithashtu edhe një shkollë fillore për vajzat po në gjuhën greke. Në historikun e arsimit Fier–Mallakastër, hartuar nga një grup punonjësish të arsimit në vitet '80 shekullit kaluar, kjo e dhënë nuk jepet. Nuk jepet madje as në kumtesa apo referime me karakter historik mbajtur nga specialist të kësaj fushe në takime, përvjetorë e simpoziume të ndryshme. Por fatmirësisht, ky fakt dokumentohet nga një shkrim analitik botuar në gazetën “Përlindja e Shqipëniës” në tetor të vitit 1913.

“Fieri, – shkruhet në këtë gazetë, – ka një shkollë qytetore djemash me tre mësues dhe një fillore çupash.” Aq interesant është ky fakt sa edhe i trishtë për shkak të mungesës së theksuar të dokumenteve të kohës. I gjithë fondi arkivor që ka patur Fieri në këtë periudhë apo edhe më vonë me ngritjen e institucioneve shtetërore në qeverinë e Përkohshme të Vlorës u dogjën nga forcat rebele të Haxhi Qamilit në verën e vitit 1914 kur qyteti u pushtua prej tyre. Sipas një dokumenti të mëvonshëm arkivor mësojmë se mësuese në shkollën greke të vajzave në Fier ka qenë Vangjeli Bitri. Vangjelia ishte nga Korfuzi dhe aty u njoh me Sotir Bitrin, një student nga Berati i cili vazhdonte shkollën në Korfuz për farmaceutikë. Çifti i dashuruar u kthye në Berat, u martua dhe

me ftesë të Sami Bej Vrionit erdhën në Fier dhe hapën farmacinë e parë të këtij qyteti. Në vitin 1920-1923 Sotir Bitri ka kryer detyrën e kryetarit të bashkisë Fier.

Në përpjekjet e pareshtura për mësimin dhe përhapjen e gjuhës shqipe në popull, patriotët fierak, krahas djemve, kanë synuar njëherazi edhe mësimin e vajzave. Ky synim ka qenë i lidhur ngushtë me emancipimin e femrës si faktor i rëndësishëm në zhvillimin perspektiv të shoqërisë shqiptare. Tentativën e parë për përfshirjen e tyre në bangat e shkollës e ka bërë Jovan Ndreko që në vitin 1908 kur në Libofshë u hap shkolla e parë shqipe dhe ai ishte mësuesi i saj i parë. Fillimisht ai solli në shkollë dy kushërirat e tij të cilat u pasuan nga 2-3 vajza të tjera nga po i njëjti fis. Por ato nuk mundën t'i rezistonin energjisë negative të mentalitetit të kohës dhe e braktisën shkollën. Pas Ndrekos u përpoq Naun Grigor Prifti (Doko) të hapte një shkollë femërore në Sheqishtë kur ishte mësues në këtë fshat, por nuk mundi. Thirrjes së tij ju përgjigj vetëm një vajzë, e cila e theu ligjin kanunor të asaj kohe vetëm për disa ditë.

Shkolla shqipe në Fier u hap më 12 shkurt të vitit 1914 në një godinë njëkatëshe në lagjen Shkozë me mësues Xhevdet Mehqemeja. Në të u rregjistruan vetëm djem dhe u quajt shkolla e çunave. Është interesant se kuadri arsimor i Fierit që në fillim me hapjen e shkollës së parë shqipe ka pasur një nivel të lartë përgatitjeje. Mehqemeja ishte nga qyteti i Beratit dhe kishte mbaruar studimet e larta për jurisprudencë në Stamboll. Pas shkollës së Fierit ai hapi shkollën shqipe në fshatin Peshtan dhe gjatë periudhës së pushtimit austro-hungarez punoi si inspektor arsimit në Berat e më pas avokat. Në vitet 1920-'23 shërbeu me detyrën e nënprefektit të Fierit.

Në periudhën e vështirë të Luftës së Parë Botërore përpjekjet për hapjen e një shkolle femërore në Fier nuk patën sukses. Në vitin 1916 në një godinë dykatëshe në lagjen "Kishë" pranë Gjanicës u hap një tjetër shkollë shqipe e quajtur shkolla nr. 2. Edhe në bangat e kësaj shkolle nuk mundi të ulej asnjë nga vajzat fierake.

Mbas Kongresit të Lushnjes dhe krijimit të qeverisë shqiptare filloi interesimi më i gjerë për hapjen e shkollave shqipe. Kjo përpjekje u shfaq në mbajtjen e kongresit pedagogjik të Lushnjes më 15 gusht të vitit 1920 i cili vuri theksin te lufta për ngritjen e shkollave dhe kompletimin e tyre me programeve arsimore të nivelit bashkëkohorë. Në këtë klimë të re të politikës arsimore, krijuar nga forcat patriotike dhe qeveria shqiptare e Sulejman Delvinës, u ndërmor edhe akti i hapjes së shkollës femërore në Fier. Shkolla u hap më 1 shtator 1920 në lagjen "Kishë" sot "Kongresi Përmetit" në godinën e shkollës nr. 2, nxënësit e së cilës u transferuan në godinën shtetërore të Bishanakës, restauruar dhe përshtatur për shkollë nga bashkia e qytetit. Fillimisht në këtë shkollë u rregjistruan 10 vajza me mosha të ndryshme midis të cilave: Ariste Pogaçe, Goni Shallvari, Marie Noti etj. Por shumë shpejt, brenda pak ditëve numri i tyre arriti në 60.

*Ish-Drejtor i Muzeut Historik, Fier

Nuri Plaku

Mësuesit e parë, Kovi Saqellari dhe Polikseni Pogaçe